



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2021

Nr. 101

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj deputetit të Republikës së Shqipërisë z. Ervin Bushati, Drejtorisë së Shkollës 9-vjecare “Misto Mame” Tiranë.

Kërkues: Qëndresa Qytetare

Kërkues: Instituti i Studimeve Politike (ISP)

Ndaj: Z. Ervin Bushati, deputet i Partisë Socialiste
Drejtorisë së Shkollës 9-vjecare “Misto Mame” Tiranë

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, germa “dh”, “f”, “n”, e 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,



VËREN:

I

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë raportuar dy denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga organizatat Qëndresa Qytetare dhe Instituti i Studimeve Politike (ISP) për shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit të datës 15.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 738 ora 18:02, të kallëzuesit Qëndresa Qytetare, pretendohet se: “Qëndresa Qytetare denoncon shkeljen e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin e Komisionit Rregullator të KQZ-së nga deputeti i Partisë Socialiste Ervin Bushati duke përdorur, brenda orarit mësimor nxënësit dhe mësuesit e Shkollës “Misto Mame”, duke shfaqur në bluzën e tij siglën e PS dhe duke deklaruar se ka dhuruar libra për ta. Postimin e ka shpërndarë në rrjetin e tij facebook”.

Sipas denoncimit të datës 15.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 706, ora 14:47 të kallëzuesit Instituti i Studimeve Politike (ISP), pretendohet se: “Ligji ndalon aktivitete politike në mjedise shkollore dhe aktualisht shkolla duhet të jetë online, megjithatë deputeti Ervin Bushati, koordinator politik i PS Tiranë ka publikuar aktivitet të tij (me siglën e PS veshur/të dukshme) me nxenës e mësues të kësaj shkolle, ku deklaroi se ka shpërndarë edhe dhurata. Përdorimi i shkollës, përfshirja e mësuesve/drejtuesve, akti i deputetit, dhuratat dhe sigla politike në shkollë, janë akte që vijnë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor”.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar sa më sipër Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi shqyrtimin bashkërisht të denoncimeve pasi konstatoi se kishin të njëjtat fakte dhe rrethana ndaj të njëjtit subjekt, në të cilat pretendohet shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së



Shqipërisë” KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjektet kallëzuese Institui i Studimeve Politike dhe Qendresa Qytetare përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Neni 92 pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton se raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

Neni 3, pika 1.3, germa “ç” e Vendimit nr. 9/2020 të KQZ-së përcakton se veprimtari e ndaluar, janë edhe ato veprimtari të cilat përfshijnë: “përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, **si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve**, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Pika 2 e nenit 3, e vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator, përcakton subjektet të cilët gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.

Duke qenë se denoncimet lidhen edhe me deputetin z. Ervin Bushati, Komisioneri konstatohet se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesit për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit.

Referuar po kësaj dispozite, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se Drejtoria e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë dhe Drejtoria e Shkollës 9 vjecare “Misto Mame”, janë subjekte të ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi.



II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Me datë 15.1.2021, janë raportuar në portalin e KQZ-së dy kallëzime nr ID 706 dhe nr ID 738, për një aktivitet të deputetit të Partisë Socialiste z. Ervin Bushati në ambientet e shkollës 9 vjeçare “Misto Mame” referuar statusit të tij në llogarinë personale në Facebook me lidhjen:

<https://www.facebook.com/ervinbushati.al/photos/pcb.1777940715705940/1777939852372693>

Gjatë shqyrtimit të të dhënave të kallëzuara vërehet se z. Ervin Bushati ka njoftuar në profilin e tij në facebook, të aksesueshëm për publikun, disa foto të shoqëruar me tekstin: Dhuruar Libra; bashkëbiseduar me mësuesit lidhur me sfidat e arsimit....”

Referuar denoncimeve të mësipërme Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1091 prot., datë 10.02.2021 ka kërkuar informacion Zyrës Vendore Arsimore Tiranë nëse kishte informacion për këto veprimtari të deputetit Ervin Bushati.

Me shkresën nr. 680/1 prot., datë 12.02.2021, administruar në protokollin e KQZ-së tonën me nr. 1183, datë 15.02.2021, Zyra Vendore Arsimore Tiranë sqaron se nuk ka patur asnjë informacion në lidhje me zhvillimin e këtyre aktiviteteve në ambientet e këtyre shkollave.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, Drejtorja e shkollës 9- vjeçare “Misto Mame” Tiranë, ka sqaruar se takimi është realizuar jashtë orarit mësimor dhe deputeti ka sjellë libra si dhuratë për shkollën, nuk ka realizuar asnjë veprimtari politike, nuk ka shpalosur asnjë program elektoral dhe nuk ka shfrytëzuar asnjë burim shtetëror.



Sipas kësaj shkrese z. Bushati nuk kishte njoftuar paraprakisht për këtë vizitë me dhurata për shkollën. Në zbatim të neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, drejtorja e shkollës (Drejtori dhe dy zëvendës drejtorët) kanë pritur Deputetin në korridorin e katit të dytë të shkollës.....”

III

Analiza juridike dhe konkluzione

Neni 2, gërma “b” përkufizon si veprimtari publike veprimtaritë të cilat janë të hapura për pjesmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim si dhe ato që kanë në agjendë informimiin në periudhën 4 mujore para datës së Zgjedhjeve deri ditën e Zgjedhjeve.

Neni 3, pika 2 e vendimit nr. 9/2020 të KQZ-së ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të të cilit përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë edhe drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive *“e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”*.

Neni 3, pika 1.3, gërma “ç” i vendimit nr. 9/2020, të KQZ-së ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë *përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve.*

Referuar sa më sipër, ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria publike është e hapur për publikun apo të medias dhe kanë agjendë informimi apo është veprimtari e ndaluar në kuptim të përkufizimeve të gërmas “ç”, pika 1.3, të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij vendimi.

Rrethanat e faktit nuk provojnë zhvillimin e një veprimtarie publike për t’u promovuar sipas përcaktimeve të pikës 1.1 të nenit 3 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Në lidhje me pretendimet e shkollës se e kanë pritur deputetin në bazë të nenit 7 dhe 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, vlerësohet se:

Në referim të deklaratave të deputetit dhe informacionit të përcjellë nga shkolla 9 vjeçare “Misto Mame” rezulton se veprimtaria nuk përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1.1 të nenit 3 të vendimit 9/2020 të KQZ-së. Gjithashtu nuk vërtetohet karakteri publik i tij qoftë nëpërmjet aksesit të publikut apo medias për të marrë pjesë në këtë veprimtari.



Në lidhje me veprimtarinë e zhvilluar nëse ajo përbën veprimtari të ndaluar sipas përcaktimeve të pikës 1.3 gërma “ç” të nenit 3 të vendimit 9/2020, ky nen ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve.

Në rastin konkret, çmohet se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të konsiderojë këtë veprimtari të ndaluar në kuptim të kësaj dispozitë për sa kohë që periudha e ndalimit për këtë veprimtari është vetëm “gjatë fushatës zgjedhore”.

Pika 1 e nenit 91 e Kodit Zgjedhor përcakton se “nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se deputeti për të aksesuar në ambjentet e shkollës është lejuar nga administrata në bazë të nenit 7 dhe 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit” i ndryshuar.

Pika 2 e nenit 3 e vendimit nr. 9/2020 të KQZ-së ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të të cilit përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë edhe drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive të cilët “e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Referuar sa më sipër, ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria publike është veprimtari e ndaluar në kuptim të përkufizimeve të gërmas “ç”, pika 1.3 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020.

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se deputeti për të aksesuar në ambjentet e shkollës është lejuar nga administrata në bazë të nenit 7 dhe 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit” i ndryshuar.

Me qëllim parandalimin e përdorimit të kësaj dispozite gjatë periudhës zgjedhore nga deputetet e Kuvendit të Shqipërisë të cilët mund të mos kenë statusin e kandidatit të regjistruar nga subjektet zgjedhore në listat shumëmemërore të tyre, çmohet bërja e një paralajmërimi në lidhje me fushën e



veprimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 3 pika 1.3 germa “ç” edhe për deputetët e RSH të cilët nuk kanë statusin e kandidatit për deputetë.

Në kuptim të nenit 7 të ligjit 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit” i ndryshuar, takimet e deputetit bëhen vetëm me drejtuesit e institucioneve në ushtrim të detyrës së tyre, ndërsa neni 8 përcakton detyrimin për t’u përgjigjur me shkrim kërkesave për informacion të deputetit.

Për sa më sipër cdo aktivitet që do të zhvillohet nga administrata arsimore me deputetë të cilët nuk gëzojnë statusin e kandidatit të regjistruar në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, do të konsiderohet aktivitet në mbështetje të një subjekti të caktuar politik.

Gjithashtu në analizë të nenit 17, paragrafi 5 dhe 6 të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” i cili përcakton se “Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike”, cmohet se kompetenca për shqyrtimin dhe analizën e fakteve në lidhje me këtë aktivitet i përket Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 18/2017 “ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” do përcjellë denoncimet dhe dokumentat e administruara prej tij në këtë procedurë administrative, për trajtim tek Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. si organi kompetent i cili monitoron dhe kontrollon zbatimin e ligjit nr. 18/2017 ligjit nr. 18/2017 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit të saj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, gjerat “dh”, “f”, “n” paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 91, 92 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 3 të vendimit 9/2020 të KQZ-së.
2. Kallëzimi dhe dokumentat e administruara në këtë procedurë administrative ti përcillen për kompetencë dhe vlerësim Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.



3. Të njoftojë Zyrën Arsimore Vendore Tiranë, Ministrinë së Arsimit , Sportit dhe Rinisë që, në respektim të standardit të zgjedhjeve dhe neutralitetit të administratës publike, deputetët, deri në datën e zgjedhjeve të mos ftohen dhe lejohen në veprimtaritë rutinë të administratës qendrore dhe vendore të tij, të cilat zhvillohen nëpërmjet kontaktit, komunikimit dhe bashkëpunimit me nxënësit dhe administratën arsimore.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga njoftimi i tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

